

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIT**

1. **Drejtuar: Operatorit Ekonomik “MF INVEST GROUP” sh.p.k & MANE/S” sh.p.k**
2. **Adresa:** Tiranë, Kashar Autostrada Tiranë-Durrës, km 9 zona kadastrale 2005 nr pasurie 1/94 & Sarandë, lagja 2, P 46
3. **NIPT:** L71830010R & J64103865K
4. **OE/BOE me nënkontraktor**
PO ☐ **JO** ☒
5. **OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**
PO ☐ **JO** ☒
6. Tipi i Kontratës: Punime ndertimi
7. Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur”
8. Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF- 55904-07-22-2025**
9. Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikualifikimi i bllokut të banimit në rrugët “Konçita Konomi”, “Tahsim Hoshafi”, “Ibrahim Pashë Vlora”.**
10. Fondi limit: **69,993,773.91** (gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e një)lekë pa tvsh.
11. **Burimi i financimit:** *të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2025*, miratuar me VKB Nr.26, datë 03.04.2025, për një ndryshim në VKB Nr.131, datë 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025” (i ndryshuar).
12. Kohëzgjatja e kontratës: 7 (shtatë) muaj.
13. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 23.07.2025
14. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 39 datë 28 Korrik 2025
15. **KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**
 - oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
 - oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “2 N” sh.p.k & “BONUS” sh.p.k

NIPT: L31615017L & K72412009E

Vlera: **45,000,002** (dyzet e pesë milion e dy) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. Operatori Ekonomik “NDERTIMI” sh.p.k

NIPT: K11325002C

Vlera: **45,168,611** (dyzet e pesë million e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “MF INVEST GROUP”sh.p.k & “MANE/S” sh.p.k

NIPT: L71830010R & J64103865K

Vlera: **45,490,504.50** (dyzet e pesë million e katërqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e katër pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. Operatori Ekonomik “BE – IS SH.P.K”

NIPT: K71412003A

Vlera: **45,757,581** (dyzet e pesë million e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k & "IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION” sh.p.k

NIPT: K01730502W & L91310511L

Vlera: **46,796,992.20** (dyzet e gjashtë million e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë njëzet) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

6. Operatori Ekonomik “Caushi M” sh.p.k

NIPT: L88419801O

Vlera: **46,895,930.55** (dyzet e gjashtë million e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë pikë pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

7. Operatori Ekonomik “INERTI” sh.p.k

NIPT: J66926804L

Vlera: **48,884,299.59** (dyzet e tetë million e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë dyqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

8. Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k

NIPT: 810802422

Vlera: **50,089,408** (pesëdhjetë million e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

9. Operatori Ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION” sh.p.k

NIPT: K51423028P

Vlera: **51,884,751.45** (pesëdhjetë e një million e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

10. Operatori Ekonomik “SENKA” sh.p.k

NIPT: J94808405Q

Vlera: **52,494,251.78** (pesëdhjetë e dy million e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

11. Operatori Ekonomik “DESARET COMPANY” sh.p.k

NIPT: K01816001J

Vlera: **53,017,206.10** (pesëdhjetë e tre million e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtë pikë dhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

12. Operatori Ekonomik “INA” sh.p.k

NIPT: J61814009W

Vlera: **53,267,784** (pesëdhjetë e treë million e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

13. Operatori Ekonomik “AGI CONS” sh.p.k

NIPT: K21622001M

Vlera: **56,385,002.54** (pesëdhjetë e gjashtë million e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dy pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

14. Operatori Ekonomik “CURRI” sh.p.k

NIPT: J67902718S

Vlera: **59,464,768.70** (pesëdhjetë e nëntë million e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “2 N” sh.p.k & “BONUS” sh.p.k

L31615017L & K72412009E

Operatori ekonomik “BONUS” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, pika 2.2.1, ku percaktohet se: *“...Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar...”*. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se Bilanci per vitin 2023 i paraqitur nga operatori ekonomik “BONUS” shpk nuk eshte i konfirmuar nga autoritetet perkatese, cka bie ne kundërshtim me kerkesat e percaktuara ne dokumentet standarte te tenderit.

Operatori ekonomik “BONUS” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, pika 2.2.3, ku percaktohet se: *“Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 si dhe këstin perkatës per vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit)”. Nga verifikimi i Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit si dhe dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi operatori ekonomik “BONUS” shpk nuk ka deklaruar shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 si dhe këstin perkatës per vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), cka bie ne kundërshtim me kerkesat e percaktuara ne dokumentet standarte te tenderit.*

Bashkimi i operatoreve ekonomik “2 N & BONUS” shpk nuk permbushin Kriteret e Pergjithshme te Kualifikimit dhe te Vecanta te Kualifikimit. Nga shqyrtimi i dokumentit Marreveshje Bashkepunimi date 28.07.2025 rezultoi se operatori ekonomik “BONUS” shpk ka marre persiper te kryeje te gjithe zerat e preventivit qe lidhen me punimet elektrike dhe duhet te kishte pjese te drejtuesve teknik inxhinier elektrik. Nga verifikimi i Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur ne sistemin e prokurimeve elektronike rezultoi se operatori ekonomik “BONUS” shpk nuk ka deklaruar Inxhinier Elektrik, cka bie ne kundërshtim me VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public” i ndryshuar, neni 88, pika 3, ku percaktohet se: “Kerkesat per kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Bashkimi i operatoreve ekonomik “2 N & BONUS” shpk nuk permbushin Kriteret e Pergjithshme te Kualifikimit dhe te Vecanta te Kualifikimit. Nga shqyrtimi i dokumentit Marreveshje Bashkepunimi date 28.07.2025 rezultoi se operatori ekonomik “BONUS” shpk ka marre persiper te kryeje 14 % te punimeve ose 6,300,000 leke pa TVSH. Nga verifikimi i Shtojces 2 “Lista e cmimeve sipas zerave te preventivit” te paraqitur ne sistemin e prokurimeve, rezultoi se bashkimi i operatoreve ekonomik ka paraqitur ndarjen e punimeve sipas preventivit te punimeve dhe operatori ekonomik “BONUS”shpk ka marre persiper te kryeje 6,001,650 leke pa TVSH ose 13.33 %, cka bie ne kundersiztim me kerkesat e percaktuara ne Dokumentet Standarte te Tenderit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. Operatori Ekonomik “NDERTIMI” sh.p.k

K11325002C

Operatori ekonomik “NDERTIMI” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3, ku percaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik (Inxhinier Ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...*”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “NDERTIMI” shpk nga deklaruar drejtuesin teknik me inicialet V.P i cili rezulton fitues dhe eshte i angazhuar ne kontratën me objekt:“*Ndertim shkolla e mesme e bashkuar Mersin Duqi, Njesia Administrative Berzhite, fshati Ibe*” lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k

810802422

Operatori ekonomik “RSM COMPANY” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3, ku percaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik (Inxhinier Ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...*”. Nga verifikimi dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezultoi se operatori ekonomik “RSM COMPANY” shpk per permbushjen e kriterit te mesiperm, ka deklaruar punonjesin me iniciale E.V i cili nga deklarimi perkates ne Formualrin Permbledhes te Vetdeklarimit rezulton Ing. Hidroteknik, cka bie ne kundersiztim me udhezimin Nr.2, date 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1, paragrafi 2, ku citohet se: “*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi*”.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. Operatori Ekonomik “SENKA” sh.p.k

J94808405Q

Operatori ekonomik “SENKA” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8, ku percaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes si me poshte...konkretisht 2 punonjes Hidraulik...*”. Nga verifikimi i Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit te paraqitur ne sistemin e prokurimeve elektronike rezultoi se operatori ekonomik “SENKA”shpk, nuk ka deklaruar e per pasoje mungojne 2 (dy) punonjes Hidraulik, cka bie ne kundersiztim me kerkesat e percaktuara ne Dokumentet Standarte te Tenderit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. Operatori Ekonomik “DESARET COMPANY” sh.p.k

K01816001J

Operatori ekonomik “DESARET COMPANY” Shpk nuk permbush kerkesat e pikes 2.3 te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit, Kapacitetit Teknik, ku percaktohet se: *“Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën.....”*.

Per permbushjen e punes se ngjashme, Operatori ekonomik ASI INVEST Shpk ka paraqitur ne Sistemin Elektronik te Prokurimit kontraten me obejkt:

1. *“Riparim dhe rinovim i shkolles se mesme profesionale te gjuheve te huaja Asim Vokshi, Bashkia Tirane”;*

Nga verifikimi rezultoi se kontrata e paraqitur ne SPE nga Operatori ekonomik DESARET COMPANY shpk, nuk eshte sipas objektit te prokurimit infrastrukture rrugore, cka bie ne kundërshtim me kerkesat e percaktuara ne dokumentet standarte te tenderit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “MF INVEST GROUP” sh.p.k & “MANE/S” sh.p.k** me adresë Tiranë, Kashar Autostrada Tiranë-Durrës, km 9 zona kadastrale 2005 nr pasurie 1/94 & Sarandë, lagja 2, P 46, me vlerë totale prej: **45,490,504.50** (dyzet e pesë million e katërqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e katër pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.